

Prezantim i temës së Kongresit të NLS 2026
Nga Patricia Bosquin-Caroz

VARITET

Variacionet e së vërtetës në psikanalizë

“Unë them gjithmonë të vërtetën: por jo të gjithën, sepse ta thuash të gjithën është e paarritshme. Ta thuash të gjithën është e pamundur, materialish: fjalët mungojnë. Dhe është pikërisht nëpërmjet kësaj pamundësie që e vërteta ngjizet me realen.”

JACQUES LACAN, *Televizion*

Kongresi i njëzet e katërt i NLS-së propozon të shqyrtojë variacionet e së vërtetës në psikanalizë. Lakani i ka kondensuar ato në neologjizmin *varitet*¹ variacionet e së vërtetës që shfaqen gjatë një analize, nëpërmjet zbulimeve të njëpasnjëshme. Ai pohon se duhet të jemi të hapur ndaj dimensionit të së vërtetës si e ndryshueshme, dhe shton se ajo që thotë i analizuari nuk është e vërteta, por vari(e)teti i *sinthome*-ës. Gjatë gjithë mësimdhënies së tij, Lacan-i nuk e ka braktisur asnjëherë referencën ndaj së vërtetës, të cilën fillimisht e ka trajtuar si *E Vërteta*, apo më vonë kur i është referuar si një të vërtete të shumëfishtë, të ndryshueshme dhe gënjeshtare. Megjithatë, një element mbetet i pandryshuar: ndërthyrja e të vërtetës, apo e efekteve të së vërtetës, me strukturën e gjuhës dhe të fjalës, madje deri me atë që Lacan-i e quan “lëngu i gjuhës” (*bouillon de langage*²).

E vërteta, saktësia dhe zbulimi

Në fillim, Lacan-i i jep vlerë një tjetër dimensionit të fjalës, përveç atij të shprehjes dhe ndërmjetësimit: zbulimit. Zbulimi i referohet shfaqjes së një të vërtete që supozohet e fshehur, e mbuluar, dhe përkon me *çastin kur shikojmë*. Kështu, e vërteta lëviz midis shfaqjes dhe shpëtimit, apo ikjes, ndërkohë që analiza përkufizohet si një seri zbulimesh të veçanta për çdo subjekt. Në tekstin e tij themelor, “Funksioni dhe fusha e fjalës dhe e gjuhës në psikanalizë”³, Lacan-i vë përballë njëra-tjetrës fjalën e plotë dhe fjalën boshe; fjala e plotë është ajo në të cilën realizohet e vërteta e subjektit. Në këtë perspektivë, e vërteta e zbulimit ka të bëjë me të vërtetën tek fjala. “Në këtë pikë, ne përplasemi me realitetin e asaj që nuk është as e vërtetë, as e pavërtetë,”⁴ Realiteti dallohet këtu nga ajo të cilës i referohemi si saktësi dhe nuk ka asnjë përputhje me një realitet objektiv. E vërteta e një fjale nuk bazohet në përputhjen e fjalës me gjënë. Vetë Freud-i, pas shumë kërkimeve, hoqi dorë nga besimi në një realitet objektiv të traumatizmave që në të pavetëdijshmen e subjektit nuk ndallon “nga

¹ Lacan J., « L'insu que sait de l'une-bévue s'aile à mourre », leçon du 19 avril 1977, inédit.

² *Ibid*

³ Lacan J., « Fonction et champ de la parole et du langage en psychanalyse », *Écrits*, Paris, Seuil, 1966.

⁴ *Ibid*, p. 256

fiksioni i investuar me ndjenja⁵”. Këtë Jacques-Alain Miller do ta formulonte në këtë mënyrë: Në analizë nuk bëhet fjalë “të thuhet ajo që është”, por “të bëhet e vërteta e asaj që ka qenë. Ka pastaj, atje, gjëra nga ato që kanë penguar bërjen e të vërtetës: trauma, ajo që ka bërë vrimë [...] Bëhet fjalë, që analiza të sjellë ligjërimin atje ku ai nuk ka mundur të zërë vend⁶”. Por, mbi të gjitha, Lacan-i do ta pozicionojë risinë e zbulimit freudian në lidhje me atë që shfaqet papritmas në ligjërimin e subjektit, i cili, nga ana e tij, “zhvillohet normalisht [...] në rendin e gabimit, të mosnjohjes, madje edhe të mohimit”⁷. E vërteta lind nga keqkuptimi, nga lapsusi, nga akti i munguar, nga ajo që pengohet dhe që “[zbulon] një të vërtetë të fshehur”, një kuptim tjetër. Ajo shfaqet në formën e një pengese që ndërpret rrjedhën e tregimit të subjektit dhe e tejkalon atë. “E vërteta e kap gabimin për jake, në keqkuptim.”⁸ Kjo do të thotë se subjekti nuk e di atë që thotë, ai thotë gjithmonë më shumë sesa dëshiron të thotë, gjithmonë më shumë sesa di të thotë.

E vërteta, ndrydhja dhe historia

Siç e saktëson Jacques-Alain Miller në tekstin e tij “Një aleancë e re me ëndjen”⁹, për Lacan-in analiza konsistonte së pari, për subjektin, në një përparim drejt Të Vërtetës së vetme, qw supozohet të shkruhet në vazhdimësinë e një historie. Termi “histori”, ashtu siç e përdor Lacan-i në “Funksioni dhe fusha e fjalës dhe gjuhës”, i përgjigjet termit të të pavetëdijshmes. “E pavetëdijshmja është ai kapitull i historisë sime që shënohet nga një boshllëk ose zëvendësohet nga një gënjeshtër: është kapitulli i censuruar.”¹⁰ Në analizë rindërtohet kjo histori. Eliminimi metodik i ndrydhjes, ngritja e perdes, bën të mundur rikthimin e vazhdimësisë dhe rigjetjen e së vërtetës së fshehur. Përvoja me histeriket i lejoi Freud-t të kuptojë se nuk duhet ngatërruar kujtesa biologjike me rikujtimet, që kanë të bëjnë me historinë e rindërtuar të subjektit. Ato nënkuptojnë *risubjektivizimin* e ngjarjes dhe *ristrukturimin* e saj në një moment të dytë (après-coup). Për këtë arsye, Lacan-i e përkufizoi fillimish psikanalizën si marrja përsipër, nga ana e subjektit, e historisë së tij, në masën që ajo ndërtohet nga fjala që i drejtohet një tjetri. Në lidhje me rastin e Dorës, ai do të përmendë më vonë shprehjen “zhvillimet e së vërtetës”, të cilat janë pjesë e “përmbysjeve dialektike”¹¹ dhe për pasojë, e përparimit të analizës. Ndrydhja dhe e vërteta bëhen atëherë antonime. “Koncepti i ndrydhjes thirret, kërkohet dhe aktivizohet nga përvoja e zbulimit.”¹² Por me rikthimin e tij tek Freud-i, Lacan-i do të vërë në dukje veçantinë e zbulimit të tij, që largohet nga vërtetësia e fakteve. Tek “Gjëja freudiane”, ai do të saktësojë se zbulimi themelor i Freud-it konsiston në pohimin se “ajo flet, madje ndoshta aty ku pritet më pak, aty ku ka vuajtje”¹³. “Unë, e vërteta, flas.”¹⁴ Le të nënvizojmë këtu që ky pohim zbulon mbi të gjitha një thëniezim dhe jo një thënie të një uni që afirmon një bindje personale kundër doktrinës universale.

⁵ Freud S., *Lettres à Éilhelm Fliess, 1887-1904*, Paris, PUF, 1956, lettre 69 du 21 septembre 1897, p. 191.

⁶ Miller J.-A., « L'orientation lacanienne. Choses de finesse en psychanalyse », enseignement prononcé dans le cadre du département de psychanalyse de l'université Paris 8, cours du 18 mars 2009, inédit.

⁷ Lacan J., *Le Séminaire*, livre I, *Les Écrits techniques de Freud*, texte édité par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1997, p. 291.

⁸ *Ibid.*, p. 292.

⁹ Cf. Miller J.-A., « Une nouvelle alliance avec la jouissance », *La Cause du désir*, n° 92, avril 2016.

¹⁰ Lacan J., « Fonction et champ... », *op. cit.*, p. 259.

¹¹ Lacan J., « Intervention sur le transfert », *Écrits*, *op. cit.*, p. 219 & 216.

¹² Miller J.-A., « La vérité fait couple avec le sens », *La Cause du désir*, n° 92, *op. cit.*, p. 87.

¹³ Lacan J., « La chose freudienne », *Écrits*, *op. cit.*, p. 413.

¹⁴ *Ibid.*, p. 409.

E vërteta dhe dija

Lacan-i filloi të vendosë kundër njëra-tjetrës të vërtetën dhe dijen dhe theksoi primacinë e së vërtetës mbi dijen. Referenca e paradoksit të Menonit, do ti shërbente atij për të mbështetur tezën se “*epistemia*, dija e lidhur me një koherencë formale, nuk mbulon të gjithë fushën e përvojës njerëzore”¹⁵. Në lidhje me *alethes doxa*, të opinionit të vërtetë, Lacan-i vërejti se “ekziston atje një e vërtetë që nuk mund të kapet nga një dije e lidhur”¹⁶. Në mënyrë të ngjashme me procesin dialektik që e gjejmë në këtë dialog mes Menonit dhe Sokratit, Lacan-i ka nënvizuar dimensionin krijues dhe shfaqës të së vërtetës me të cilën ne punojmë, e cila nuk është ajo e një dijeje tashmë të formuar.

Përmbysja

Lacan-i nuk do ta mbajë më këtë kundërshti mes së vërtetës dhe dijes. Duhet pritur “Propozim mbi psikanalistin e Shkollës” për të parë artikulin e parë mes të dyjave, të cilin ai do ta formalizojë në matemën e ligjërit analitik. E vërteta dhe dija nuk ndahen në dy klasa të ndryshme. “Ajo që, në momentin që lind, paraqitet si e vërtetë, bëhet dije duke u regjistruar dhe depozituar.”¹⁷ Propozimi i kalimit (la passe) përfshihet në këtë perspektivë të një dije mbi të vërtetën e pavetëdijshme. E vërteta paraqitet fillimisht si mungesë dijeje, shfaqet përmes asocimit të lirë dhe në fund merr formën e një dijeje. “Ajo artikullohet në një zinxhir shkronjash aq rigoroz, thotë Lacan-i, sa nuk duhet humbur asnjëra, pa-dija sillet si kuadri i dijes”¹⁸. Lacan-i gjithashtu përcakton në terma të dijes ndryshimin që ndodh në fund të analizës, nga qenia e dëshirës drejt qenies së dijes. Vihet re se nuk bëhet më fjalë për *të vërtetën që thotë unë flas*, por për “një të vërtetë të lidhur me zinxhirë, të zbratur nga kuptimi dhe, për rrjedhojë, nga pasioni”¹⁹. Dispozitivi analitik konsiston atëherë në mbledhjen e shënjesve që kanë një vlerë të vërtete, atyre që kanë peshë për subjektin. Ai implikon aktin e analistit në izolimin e këtyre shënjesve.

E megjithatë, Lacan-i e zhvlerëson dijen, kur i qaset reales. Në seminarin e tij *Encore*, ai përmend termin “bollëk dijesh mbi gjuhën (lalangue)”. Struktura e gjuhës vendoset atëherë në nivelin e fiksionit, ndërsa e pavetëdijshmja kuptohet si “një zotësi me lalangue-n”²⁰. Por, çfarë bëhet me të vërtetën pas kësaj? Çfarë ndodh me zbulimet?

E vërteta mashtruese dhe fiksioni

Efektet e zbulimit shënjojnë rrugëtimin analitik deri në një pikë të caktuar. Ato tregojnë se e vërteta prodhohet në fjalë; për këtë arsye, Lacan-i ka mbrojtur idenë që e vërteta ka strukturën e një fiksoni. Që në fillim, ai kishte saktësuar se termi *fiksion* nuk përfaqëson as iluzionin dhe as mashtrimin. Karakteri i fiksionit të mitet dhe teoritë seksuale infantile e dëshmon këtë. Struktura narrative e përmbajtjes së tyre bën të mundur trajtimin e temave të tilla si vdekja, ekzistenca dhe jo-ekzistenca, pra atyre që i përkasin rendit të gjërave të pamunadura për tu thënë. Po ashtu, ajo përbën një dimension thelbësor të përvojës analitike. Megjithatë, analiza

¹⁵ Lacan J., *Le Séminaire, livre II, Le moi dans la théorie de Freud et dans la technique de la psychanalyse*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1978, p. 26.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Miller J.-A., « Le paradoxe d'un savoir sur la vérité », *La Cause freudienne*, n° 76, décembre 2010, p. 124.

¹⁸ Lacan J., « Proposition du 9 octobre 1967 sur le psychanalyste de l'École », *Autres écrits*, Paris, Seuil, 2001, p. 249.

¹⁹ Miller J.-A., « Le paradoxe d'un savoir sur la vérité », *op. cit.*, p. 129.

²⁰ Lacan J., *Le Séminaire, livre XX, Encore*, texte établi par J.-A. Miller, Paris, Seuil, 1975, p. 127.

mund të shkojë deri në regjistrin ku e vërteta nuk ka më vend: atë të ëndjes, pikës kufitare të rrëfimit që mbart zbulimi. Nuk mund të thuhet e vërteta mbi ëndjen dhe as gjithë e vërteta. Në lidhje me këtë, mund të vëmë re se Lacan-i nuk ka është pajtuar asnjëherë me idenë e një transparence të fjalëve në lidhje me Gjënë (La Chose), as të kuptuarin e së vërtetës si një të plotë. Nuk mund të bëjmë më tepër se sa ti sillemi rrotull me gjys-të-thëna. Si pasojë, fjala që ndërtohet nga ligjërimi analitik i përket fiksionit, të vërtetës mashtruese. Gjuha është dukje (semblant) dhe, përballë reales, nuk mund të bëjë tjetër veçse të gënjejë. Freud-i e kishte zbuluar funksionin e *proton pseudos* në rastin e Emmës. Pra të gënjeshtër, nuk do të thotë të vihesh përballë kundërshtisë mes të vërtetës dhe gënjeshtërës.

Në seminarin e tij të parë, Lacan-i theksonte tashmë se fjala shpaloset në dimensionin e të vërtetës mashtruese. E vërteta është gënjeshtër sepse ajo varet nga rrëfimi, ndërtimi, dhe kuptimi që u jepet ngjarjeve. Referenca ndaj tekstit “Parathënie për botimin anglisht të Seminarit XI”, ku Lacan-i përmend termin e së vërtetës mashtruese, mund të lexohet si kundërpeshë e “Funksionit dhe Fushës...”, ashtu si J.-A. Miller na ka ftuar ta konsiderojmë. Lacan-i përmend një regjistër tjetër ku e vërteta nuk është më pjesë e lojës, në mos për të gënjyer, atë të ëndjes dhe përmbushjes së saj. E vërteta mashtruese bëhet atëherë një masë dijesh mbi realen, gjë që nuk pengon prodhimin e efekteve të së vërtetës, ndaj të cilave analisti duhet të jetë i vëmendshëm. “Psikanaliza është ajo që bën të vërtetën, por si duhet kuptuar kjo bërje e të vërtetës? Është një goditje kuptimi, një kuptim i bardhë”²¹, thotë Lacan-i.

E vërteta, ndërprerje dhe variacione

Për Lacan-in, e vërteta nuk mund të kuptohet pa një rrëfim që i kthen vazhdimësinë historisë së subjektit, duke i dhënë kuptim gjërave që nuk janë thënë apo janë thënë keq. Rrëfimi “[merr] përsipër atë që ka mbetur si vrimë në realitetin e subjektit [për t’iu dhënë] kuptim traumave të tij, imazheve të pashlyeshme, skenave monumentale”²². Qëllimi është rikthimi i vazhdimësisë nga një vrimë te tjetra, duke treguar një histori për një tjetër. Por idenë ideale të një historie që ka rifituar vazhdimësinë e saj, Lacan-i do ta zëvendësojë me konceptin e një historie të ndërprerë, të përbërë nga copa të shpërndara, shpërthime, shfaqje dhe zbulime. Ndërprerja narrative vë në dyshim idenë e një të vërtete të vetme dhe të qartë. “Vetë artikuli i ligjëritimit analitik e çon të analizuarin drejt ndërtimit, thurjes së rrjetës të të vërtetës mashtruese, një rrjete që ndryshon, varion, rrjetë e një të vërtete që priret të gënjejë, që është vetëm kalimtare, dhe thurja e kësaj rrjete bëhet me rastësitë e së kaluarës dhe rastësitë e përditshme.”²³

Kështu, në një analizë, zbulimet pasojnë njëra-tjetrën duke vënë, herë pas here, në dyshim zbulimet e mëparshme. Veç të tjerash, përmes rimeve dhe pikëzimeve të analistit, akti i tij kontribuon në krijimin e varieteteve të së vërtetës. Në këtë mënyrë merr kuptim e pavetëdijshmja, kuptim që nuk pushon s’u interpretuari në mënyra të ndryshme. E vërteta varion, merr formë të shumta, ndërsa *historia* duhet kuptuar tashmë si ajo që ndërtohet për një tjetër në një dimension transferencial. Nuk ekziston vazhdimësia ideale, por vetëm një histori transferenciale dhe unike.

Një gjë është e sigurt, variteti, variacionet e së vërtetës, vazhdojnë të preokupojnë psikanalizën. Në erën e post-të-vërtetës, variteti shkon kundër rrymës të ligjëritimit dominues

²¹ Lacan J., « L’insu que sait... », *op. cit.*, leçon du 10 mai 77.

²² 22. Miller J.-A., « La vérité fait couple avec le sens », *op. cit.*, p. 88.

²³ Miller J.-A., « L’orientation lacanienne. Choses de finesse en psychanalyse », *op. cit.*, cours du 11 février 2009.

ku referenca ndaj të vërtetës është zhdukur, me pasojë zhvlerësimin dhe madje degradimin e vlerës së fjalës. Qëllimi i kongresit tonë do të jetë valorizimi i dimensionit etik të marrëdhënies së subjekteve me të vërtetën, me fjalën, gjë që është kusht për *analizueshmërinë* e tyre. “Prova e të vërtetës është analiza, atje ku përpiqesh të thuash të vërtetën, ndërsa partneri analist është aty për të të frymëzuar një lloj pasioni për të thënë vërtet.”²⁴

²⁴ Miller J.-A., « La passe bis », *La Cause freudienne*, n° 66, juin 2007, p. 211.